

**NË BELO HORIZONTE U HAP EKSPOZITA E SHUMËPRITUR
<<DHURATË DASHURIE>> ME POEZITË E POETIT KOSOVAR TË
MIRËNJOHUR NË MINAS GERAIS DHE PËRGJITHËSISHT NË BRAZIL:**

**ENGJËLL KOLIQUI
NJË ARTIST I KOMPLETUAR**



Engjëll Koliqi me poeten e madhe Beth Fleury,
e cila ka shkruar për fëmijët e Kosovës

Gjithçka për këtë ekspozitë të mrekullueshme, çfarë deri më tash nuk është parë në Belo Horizonte, është meritë e profesoreshave të famshme, të nderuara dhe shumë të respektuara nga të gjithë, edhe pse tashmë të pensionuara – Prof Dr Vera Lucia Alves Neves e Prof Esmeralda Carvalho Castro, në kuadër të Organizatës Ndërkombëtare CAN (organizatë për planifikim dhe implementim projektesh ndërkombëtare, ushtrime e planifikime ligjërata, organizime konferencash dhe shoqërim misionesh nga jashtë), dhe natyrisht e autorit, i cili nga të pranishmit u vlerësua si një artist i kompletuar.

Shkruan: Caio Werneck

Belo Horizonte, 5 qershor 2007. – Siç kam shkruar dy ditë më parë, gjithçka ishte përgatitur me kohë për ekspozitën e mrekullueshme “Dhuratë Dashurie” me poezitë e poetit të mirënjohur kosovar Engjëll Koliqi-t, që mbrëmë, me fillim në ora 20 u hap në shtëpinë e intelektualëve të Belo Horizonte-s, siç quhet këtu lokali i pronarit Julius Cesar Pereira “Alexandrina Café Cultura e Moda”. Poezitë e mrekullueshme – siç i kanë vlerësuar shumë mysafirë në librin e përshtypjeve të hapur nga organizatorët, si dhe muzika shumë e këndshme shqiptare, e interpretuar nga vetë Koliqi, me çifteli, kanë bërë që festa e mbrëmshme të jetë vërtetë e paharrueshme për të gjithë dhe të zgjas deri në orët e mëngjesit, çfarë nuk ishte përjetuar në rastet identike të mëparshme.



Me kryeorganizatoren - profesoreshën e nderuar Dr Vera Lucia Ales Neves dhe Márcio Velloso (supermbikëqyrësi i Prefekturës së Belo Horizonte-s për bashkëpunim ndërkombëtar)

Në këtë festë të madhe kishin mbërritur shumë intelektualë të kryeqytetit mineir dhe të qyteteve të tjera – politikanë e përfaqësues institucionesh shtetërore (nga qeveria, nga parlamenti, nga prefektura...), gazetarë, shkrimtarë, poetë të njohur, artistë, këngëtarë, studentë..... Në radhët e mysafirëve kishte edhe pleq të moshës mbi 80 vjeçare, të cilët thonin se duke lexuar këto poezi i harrojnë vitet e kaluara dhe ndjehen krejtësisht të rinj. Shumë nga të rinjt thonin se me poezitë e Engjëll Koliqit po mësojnë vërtetë se ç'është dashuria, dashuria univerzale që ka edhe fuqinë e shumë ndryshimeve pozitive në rendin shoqëror në mbarë rruzullin tokësor. Vlerësim i gjithanshëm, në këtë mbrëmje shumë të këndshme kulturore, me protagonistin e nderuar kosovar, ishte se *poezia e Koliqit është një poezi shumë origjinale dhe shumë speciale, një poezi e thjeshtë, por me shumë delikateca, që përvetëson çdo zemër të qenieve njerëzore dhe që ka fuqinë e madhe për të inicuar ndërrime në botë dhe në shpirtëra njerëzish – me dashuri. Poezia e këtij poeti të një rangu të lartë është vlerësuar edhe si terapi shëruese e zemrave njerëzore, rivitalizim edhe i të lënëve anash e i të harruarve..... Është vlerësuar si një çerdhe e vatër tipike e dashurisë së vërtetë njerëzore dhe pasqyra më reale e të gjitha profileve të jetës njerëzore, në të gjitha kategoritë dhe në të gjitha stinët, respektivisht moshat, duke përfshirë – siç thotë shpesh autori – edhe stinën e pestë e duke e lulëzuar gjithnjë e më bukur shekullin tonë, me emrin e dashurisë. Anëtarë të Akademisë Letrare të Belo Horizonte-s, të pranishëm në festën e madhe me poezitë dhe këngët e Engjëll Koliqit, kanë thënë se miku dhe kolegu i tyre kosovar duhet anëtarësuar sa më parë në këtë akademi, sepse na ka sjellë një freski shumë të këndshme dhe një frymë shumë speciale në fjalën e shkruar artistike, ndërkaq këngëtarë vendorë të pranishëm i kanë kërkuar poetit kosovar që të shkruaj këngë, që ata do t'i interpretojnë me shumë kënaqësi nëpër skenat e pallateve kulturore dhe nëpër studiot radiotelevizive.*

Me pamundësinë e paraqitjes së mendimeve dhe përshtypjeve të të pranishmëve, që janë të shumta, po japim vetëm disa deklaramë të tyre dhe të organizatorëve, përfshirë edhe autorin e këtyre poezive të mrekullueshme.

- Prof Dr Vera Lucia Alves Neves (presidente e Organizatës Ndërkombëtare CAN – organizatoja kryesore e kësaj ekspozite, duke iu drejtuar poetit kosovar: - ***Personat nuk takohen rastësisht, por në njëfarë mënyrë, gjithnjë është një veti dhe një karakter e dhunti speciale që i tërheq.... Ti ke ardhur të na sjellësh të gjithë ne thjeshtësinë e afektit dhe***

unë shpresoj të jem personi që mund të ofroj gjithçka mundem nga kapacitetet e mia, falë oportunitetit që të njoha mirë dhe të ndjej shkëlqimin e vezullimave të artit tënd!

- Prof. Esmeralda Carvalho Castro (drejtoresha organizative e CAN), që ka punuar shumë në përgatitjen e ekspozitës: - *Është gëzim i madh të dijmë se ne – njerëzit vullnetmirë dijmë të duhemi, të ndihmohemi e të respektohem mes nesh, pa u interesuar për origjinën tonë, ngjyrën e lëkurës, për përkatësinë etnike, besimin religjioz e të pavarur nga pushteti social, ekonomik e politik, mu përmes të këtyre poezive të mrekullueshme. Engjëll – vëllai ynë, falënderojmë Zotin që patëm fatin të të njohim dhe të të kemi mes nesh, me këtë talent kaq të madh!*
- Pedro Henrique Magalhães Azevedo (prijës i Grupit të Studjuesve të së Drejtës Ndërkombëtare të Univerzitetit FUMEC në Belo Horizonte): - *Më kishin përshkuar emocione të mëdha kur dëgjoja ligjëratën prekëse të ambasadorit të madh kosovar në mesin tonë, por emocionet e mia janë shumë më të mëdha tash kur po lexoj këto poezi të bukura të Engjëll Koliqit. Unë kam menduar se dashuria nuk duhet të jetë e shprehur me fjalë e të dëgjohet, por vetëm të ndjehet në zemër, por me leximin e këtyre poezive kam mësuar dhe kuptuar mirë se edhe me gjeste të thjeshta e me fjalë të zgjedhura nga thjeshtësia shpirtërore, dashuria është delikate dhe plotësisht e frytshme në të gjitha aspektet e jetës, si lidhje e fortë mes dy personash, por edhe mes popujsh, për të mirën e përbashkët! Në emër të grupit tonë studjues të së drejtës ndërkombëtare, shpreh gatishmërinë tonë të përbashkët, për të ndihmuar konkretisht Kosovën dhe popullin e saj, që e dëshirojmë si një kopsht gjithmonë të lulëzuar që e vezullon mbarë hapsirën ballkanike!*
- Antonio Carlos de Magalhães (NHONHÔ) – këngëtar i mirënjohur mineir, i cili është i dashur dhe shumë i kërkuar në mbarë Brazilin dhe jashtë, i drejtohet poetit me këto fjalë: - *Kënaqësia ime kur jam afër teje është shumë e madh, artist i dashur kosovar, gjithmonë i hareshëm dhe me fuqi bindëse! Jam shumë i emocionuar me poezinë dhe me këngën tënde. Je një artist plotësisht i kompletuar dhe shpresoj të kem fatin të bashkëpunoj me Ty. Do të ishte nde ri madh për mua të këndoj këngë me tekste tua! Me devocion artisti, një përqaftim të fortë!*
- Beth Fleury (poetja e madhe, e cila qysh në vitin 1998 ka shkruar poezi prekëse kushtuar fëmijëve të Kosovës), i drejtohet poetit kosovar, më sa vijon: *I dashur Engjëll, poezia jote është një sentiment dramatik dhe shumë e dendur. Ajo depërton lehtë në brendinë e njeriut dhe patjetër që nxit shumë impresione dhe emocione! Një përqaftim të fortë Ty dhe mbarë bashkëkombasve tu!*
- Engjëll Koliqi (autori i poezive – artisti i kompletuar): - *Jam shumë i emocionuar dhe i impresionuar me mikpritjen dhe zemërgjerësinë e gatishmërinë e miqve të mi mineirë dhe përgjithësisht brazilianë, për të më ndihmuar mua, popullit tim e vendit tim. Me këto fjalë të mëdha vlerësimesh, sa më jepni forca të reja për të vazhduar me shkrime, aq më shumë më shtoni përgjegjësinë për çdo fjalë që bëj publike, sepse ju më bëni të kuptoj se fjalët e mia, edhe pse të thjeshta kanë depërtuar edhe në brendi të zemrave njerëzore! Një falënderim të përzemërt dhe shumë të devotshëm për të gjithë ju, e sidomos për organizatorët e kësaj ekspozite madhështore, që më bënë shumë nder këtu, ku veç ndjehem si në shtëpinë time! Ju ftoj së shpejti në një festë modeste, por besoj të bukur dhe të hareshme, për njohjen ndërkombëtare të pavarësisë së vendit tim – Kosovës! Ju dua shumë!*